

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E  
PRONËSISË INDUSTRIALE

AGJENCIA SHETËRORE PËR  
MBËSHETJEN DHE ZHVILLIMIN E  
STARTUP-EVE DHE LEHTËSUESVE

Nr. 2843 Prot.

Nr. 80 Prot

---

### MARRVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot në Tiranë, më datë 24 . 07 . 2024 ndërmjet:

- I. **DREJTORISË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE**, institucion publik jobuxhetor, i ngarkuar me ligj për regjistrimin, administrimin dhe promovimin e objekteve të pronësisë industriale, e ngritur në formën e një agjencie autonome nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë, me seli në Tiranë, me adresë “Bulevardi “Zhan D’Ark”, Shtëpia e Ushtarakëve, Prona Nr. 33, Tiranë”

Përfaqësuar në këtë Marrëveshja nga Drejtor i Përgjithshëm, znj. Maria SOLIS.

- II. **AGJENCIA SHETËRORE PËR MBËSHETJEN DHE ZHVILLIMIN E STARTUP-EVE DHE LEHTËSUESVE**, e njohur si “Startup Albania”, person juridik publik, në varësi të Ministrit të Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, ngritur me Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 467, datë 26.7.2023 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve dhe Lehtësuesve” me seli në Tiranë, me adresë Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, Tiranë.

Startup Albania është përgjegjës për menaxhimin dhe monitorimin e masave mbështetëse financiare nëpërmjet fondeve publike ose të tjetërve për nismat në ekosistemin e startup-eve në Republikën e Shqipërisë;

- vetë ose, kur është rasti, në bashkëpunim me institucione të tjera publike ofron shërbimin startup one stop-shop për mbështetjen e startup-eve dhe lehtësuesve;

- organizon punën për promovimin në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të nismave në ekosistemin e startup-eve të Republikës së Shqipërisë;

- organizon punën në cilësinë e organit mbështetës për startup-et dhe lehtësuesit, duke bashkëpunuar me palët e treta, me synim tërheqjen dhe mbështetjen e financimeve nga donatorë të huaj për ekosistemin e startup-eve në Shqipëri;

Përfaqësuar në këtë Marrëveshje nga Drejtori i Përgjithshëm, z.Arjan YMERI.

## ***PREAMBUL***

*Duke vlerësuar faktin që Pronësia Industriale është dhe mbetet një shtyllë e rëndësishme për ngritjen dhe zhvillimin e një veprimtarie të qëndrueshme ekonomike; Ekzistencën e një nevojë të menjëhershme për mbështetjen ligjore dhe institucionale të pronësisë industriale, me qëllim mbrojtjen e subjekteve të kësaj pronësie; Interesin e përbashkët të palëve për promovimin dhe përmbushjen e objektivave të përgjithshme për mbrojtjen e pronësisë industriale, që angazhohen në këto veprimtari; Dakordësinë mbi rëndësinë që paraqet ndërgjegjësimi publik mbi pronësinë industriale dhe lidhjen e drejtpërdrejtë që ajo mbart, me biznesin në vend*

***Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi,***

### **Neni 1 Qëllimi**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi ka për qëllim mbështetjen e startupeve në fushën e pronësisë industriale. Marrëveshja synon t'i lehtësojë biznesit start-up njohjen dhe zbatimin e konceptit të pronësisë industriale nëpërmjet:

- a. Identifikimit të mekanizmave të shpërndarjes së informacionit në lidhje me pronësinë industriale, në bashkëpunim me biznesin startup t'i përçohet informacioni dhe njohuria përdoruesve të tjerë të pronësisë industriale;

- b. Shpërndarjes së materialeve informuese;
- c. Ofrimi i shërbimit të IP -prediagnostic një mjet shumë i rëndësishëm për të bërë strategjinë e PI.
- d. Organizimit e tryezave të rrumbullakta të përbashkëta, trajnimeve të ndryshme brenda vendit, sesione bisedimesh (workshops) dhe dhënien e asistencës nga specialistët e DPPI-së, përta s i përket pronësisë industriale biznesit start-up në vend;
- e. Shkëmbimin e ndërsjellhtë të informacionit.

### **Neni 3** **Modalitet e Bashkëpunimit**

1. Secila Palë do të caktojë një koordinator të Marrëveshjes, përgjegjës për zbatimin e saj; konkretisht nga ana e Agjencisë Startup Albania, do të jetë Jorina Kadare, Përgjegjës Sektori, Sektori i Mbështetjes së Ekosistemit, dhe nga DPPI, do të jetë Drejtoria e Koordinimit, Promovimit, Trajnimeve dhe Analizës;
2. Ngritja e një grupi të përbashkët pune, për konkretizimin e bashkëpunimit me veprimtari të ndryshme;
3. Organizimin dhe vënien në dispozicion për start-upet, të informacionit dhe rezultateve të çdo veprimi të përbashkët, nëpërmjet medias së shkruar dhe asaj vizive;
4. Grupet e përbashkëta, do të përpunojnë mënyrat dhe veprimet e përbashkëta, për përmbushjen e qëllimit të kësaj Marrëveshjeje.



### **Neni 4** **Afati i Marrëveshjes**

Kjo marrëveshje, lidhet për një afat të pacaktuar. Përmbajtja e kësaj marrëveshjeje, mund të ndryshojë me pëlqimin me shkrim të të dyja palëve.

Secila Palë mund të tërhiqet nga zbatim i kësaj Marrëveshjeje, nëpërmjet një njoftimi paraprak me shkrim drejtuar Palës tjetër, të paktën një muaj përpara.

### **Neni 5** **Hyrja në fuqi**

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi me nëshkrimin e saj nga Palët.  
Marrëveshja hartohet në 2 kopje, në gjuhën shqipe.




U nënshkrua sot, më datë 24. 07. 2024

Për:

Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale

*Maria Selis*

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Për:

Startup Albania

*[Signature]*

DREJTORI PËRGJITHSHËM

